



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PML.nr.359/2024

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare, Mejreme Memaj e Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale të të dënuarit F. S., nga M., rruga A. G., nr..., për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, parashikuar me nenin 273 par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (nr.04/L-082), duke vendosur përkitazi me kërkesën e mbrojtëses se të dënuarit për mbrojtje të ligjshmërisë avokates Fatmire Braha, të paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda P.nr.32/2017 datë 12 korrik 2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me 26 qershor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtëses se të dënuarit F. S. për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda P.nr.32/2017 datë 12 korrik 2023.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin P.nr.32/2017 datë 12 korrik 2023, i ka shpall fajtor të pandehurit E. P. e F. S. për shkak se si bashkëzekutor kanë kryer veprën penale posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, parashikuar me nenin 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, për të cilën i ka gjykuar secilin veç e veç me dënim burgimi në kohëzgjatje prej nga dy (2) vite, në të cilin ju është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej 9.11.2026 deri me 7.02.2017, dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind)€, të cilën gjobë janë obliguar që ta paguajnë në afat prej 90 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në rast se të pandehurit nuk e paguajnë gjobën konform nenit 46 par.3 të KPRK e njëjta do tu zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që në një ditë burgimi do tu llogariten 20€ të gjobës. Konform dispozitës së nenit 69 par.1 e 2 të KPRK ndaj të pandehurit E. P. është shqiptuar edhe dënimi plotësues – konfiskimi i automjetit të markës “R.

C.”, me tabela të regjistrimit ..., në emër të personit V. P. (vëllai i të dënuarit) si send i përdorur për kryerjen e veprës penale.

Konform dispozitës së 273 par.5 të KPRK u janë konfiskuar 504 copë tableta të narkotikut MDMA-e njohur si ekstazi me peshë të përgjithshme prej 207.77 gram, dhe substanca narkoike e llojit marihuanë në sasi prej 0.62 gram.

Aktgjykimi i lartcekur në procedurën ankimore me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.603/2023 datë 7 shkurt 2024 është vërtetuar sipas ankesës së prokurorit dhe atyre të mbrojtësve të të pandehurve.

Kundër këtyre aktgjytimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësja e të dënuarit F. S. avokatja Fatmire Braha, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, dhe shkeljeve tjera të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që kërkesa të aprovohet, aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim apo të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza.

Prokurori i Shtetit me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr.205/2024 datë 10 qershor 2024 me propozim që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi:

-kërkesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësja konsideron se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.2 pika 2.5 të KPP, sepse është bazuar në provë të papranueshme, dhe pikën 2.7 pasi që nuk është përpiluar në pajtim me nenin 369 të KPP. Sipas kërkesës substanca narkotike e përshkruar në dispozitiv të akuzës nuk është vërtetuar se është substancë narkotike apo preparat i shpallur me ligj si narkotikë, pasi që me ligjin për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursor nr.02/L-128 dhe as në shtojcat – tabelat dhe klasifikimin e bimëve narkotike nuk është e përfshirë substanca narkotike- ekstazi apo MDMA. Madje, edhe nga dëgjimi i ekspertit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë në shqyrtimin gjyqësor del se kjo substancë nuk parashihet me ligjin e lartcekur, përveç kësaj ky ekspert ka deklaruar se vet fakti apo emri i tij 3.4 metilen, dioksid metanfetaminen konfirmon metanfetaminen si përbërës të MDMA por dallon nga metafetamina. Dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin, i njëjti nuk përmban arsyetim të drejtë të bazuar në prova konkrete, e të artikuleshme lidhur me veprimet inkriminuese të të mbrojturit të tij dhe ekzistimit të përgjegjësisë penale për veprën penale për të cilën është shpall fajtor në drejtim të asaj se me cilën provë të vetme bindëse dhe të pranueshme në aspektin ligjor e të administruar në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar fakti se i dënuari është penalisht përgjegjës për këtë veprë penale.

Sipas mbrojtëses si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit. Pretendimet në akuzë nuk kanë mbështetje në prova konkrete ngase, për tu plotësuar elementet- tiparet e figurës së veprës penale nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK duhet që në veprimet e të pandehurit të vërtetohet qëllimi – dashja e që gjatë shqyrtimit gjyqësor kjo nuk është argumentuar me prova konkrete. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë vendimet i kanë marrë pa u bazuar në asnjë provë

konkrete, dhe në kundërshtim me provat pasi që eksperti ka deklaruar se substanca ekstazi nuk është e paraparë me ligjin e Kosovës për substanca narkotike. Gjykata është e detyruar të vendos në bazë të fakteve të vërtetuara nga provat konkrete relevante bindëse e jo në bazë të supozimeve, aq me tepër kur sipas parimit “in dubio pro reo”- që parashihet në nenin 3 par.2 të KPP mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij. Në rastin konkret provat materiale nuk e inkriminojnë të dënuarin F. S., kurse konform dispozitës së nenit 262 të KPP – gjykata nuk e shpall fajtor të akuzuarin duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie ose një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale; gjykata nuk e shpall fajtor të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaratimit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit, gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin dhe gjykata nuk e shpall fajtor të akuzuarin vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e lartcekura nuk janë të bazuara. Aktgjykimet e lartcekura nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.5 e 2.7 të KPP siç pretendohet në kërkesë. Se pari, me dispozita ligjore – nenin 251 të KPP është përcaktuar se kur një provë konsiderohet e papranueshme dhe sipas kësaj dispozite provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme, kurse, siç del nga shkresat e lëndës provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje janë marrë konform dispozitave ligjore, ndërsa, sa këto prova janë thellësisht të mbështetshme respektivisht provojnë elementet e veprës penale, shkaktimin e dëmit apo ndonjë çështje me rëndësi është çështje që vlerësohet nga Gjykata. Në rastin konkret ekspertiza laboratorike përkritazi me substancën narkotike që është objekt i akuzës është marr konform dispozita ligjore, ndërsa a e argumenton kjo ekspertizë faktin se substanca narkotike e gjetur tek i dënuari është substancë narkotike është çështje e vlerësimit të gjykatës, për çka do të behet fjalë në kuadër të pretendimeve të shkeljes së ligjit penal.. Ndërsa, të pabazuara janë pretendimet se nuk janë dhënë arsye përkritazi me veprimet inkriminuese të të dënuarit dhe provat që kanë argumentuar këtë fakt, ngase gjykatat në këtë drejtim kanë dhënë arsye të qarta. Në të vërtetë gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar dhe ka dhënë arsye të qarta për vërtetimin e tillë të fakteve, ka përshkruar rezultatin e procedurës provuese duke arsyetuar se pse disa fakte i merr si të provuara e disa jo të cilat si të drejta i ka vlerësuar edhe gjykata e shkallë së dytë dhe si të tilla i vlerëson edhe kjo gjykatë. Kurse, pretendimet se në rastin konkret është shkelur dispozita e nenit 262 të KPP (tani neni 257), nuk janë të bazuara, dhe për këtë gjykatë nuk është e qartë se në çka konsistojnë pretendimet e mbrojtësit duke pasur parasysh faktin se kjo dispozitë i referohet kufizimit të provave nga gjykata në rastet kur një dëshmi apo provë nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës, deklarata e të pandehurit në polici ose para prokurorit të shtetit, dëshmisë së dëshmitarit identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin, dhe dëshmisë së dëshmitarit bashkëpunuese dhe që në rastin konkret asnjëra situatë nuk ekziston.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate edhe pretendimet e mbrojtëses se në rastin konkret është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit ngase nuk është provuar se i mbrojturi i saj e ka kryer veprën penale nuk janë të bazuara. Në fakt siç del nga shkresat e lëndës i dënuari është akuzuar dhe shpall fajtor për shkak se në marrëveshje paraprake dhe në bashkëkryerje pa autorizim ka

blerë me qëllim shitje substanca apo preparate të shpallura me ligj si narkotikë ashtu që ka siguruar një sasi të madhe të substancave narkotike të llojit MDMA (e njohur si ekstazi) gjithsej 504 tableta me peshë të përgjithshme prej 207.77 gram. Rezulton se këtë sasi i dënuari e ka siguruar nga një person i nacionaliteti serb i quajtur B., ani pse mbrohet se kinse ky person çantën e kishte lënë në hotel dhe ky e kishte marr ngase ju kishte zhytur çanta e tij dhe nuk e ka ditur se në të ka substanca narkotike. Sipas ekspertizës laboratorike të Agjencisë së Forenzikës së Kosovës del se tek dëshmitë e gjetura tabletat me ngjyrë të gjelbërt të çelët dhe të portokallit është prezent MDMA (3.4 methylendioxyamphetaminë). Eksperti i kësaj ekspertizë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se emri kimik i kësaj substance narkotike MDMA e njohur si ekstazi është metilen disoksid metamfetaminë sepse është komponim sintetik dhe në bashkëveprim me substanca tjera ka fituar këtë përbërës. Pra, prezent është substanca metamfetaminë në kuadër të MDMA-së e njohur si ekstazi por lidhjet dhe elementet e tjera e bëjnë një substancë e cila dallon prej substancës së metamfetaminës. Sipas eksperti kjo substancë është drogë e fortë simulative, drogë sintetike e cila prodhohet e cila prodhohet nëpër laborator të ndryshëm.

Duke pas parasysh këtë gjendje të fakteve janë tërësisht të pabazuara pretendimet se nuk është provuar se i dënuari e kanë kryer veprën penale. Në të vërtetë, është evidente se ekstazia si substancë narkotike nuk është e paraparë shprehimisht si substancë narkotike me Ligjin për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursor nr.02/L-128 të Kosovës, mirëpo, behet fajlë për drogë sintetike – komponim sintetik në bashkëveprim me substanca tjera, dhe ky komponim përfitohet nga metamfetamina e cila është substancë psikotropike e listuar në tabelën I të ligjit të lartcekur, dhe është irelevant fakti se pas komponimit nuk është e njejtë me metamfetaminën.

Vlen të theksohet se mbrojtësja e kundërshton edhe vendimin për dënim, por këto pretendime nuk qenë objekt shqyrtimi ngase përkitazi me këtë bazë ligjore nuk mund të ushtrohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.

Nga sa u tha më lart dhe në kuptim të nenit 437 e 438 të KPP-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
PML.nr.359/2024, me 26 qershor 2024

Procesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka